



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 1701/6 prot.

Tiranë më/3/12.2021

REKOMANDIM

Nr. 62, datë 13 . 12 .2021

PËR KONTROLLUESIN “ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
LUSHNJË”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Lushnjë” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 152, datë 14.10.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), si dhe në mbështetje të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, datë 03.06.2021 “Për miratimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2020”, u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është përgjegjës për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tij, duke siguruar cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar në nivel rajonal dhe ndër të tjera, menaxhon, mbikëqyr, vlerëson dhe

kontrollon institucionet arsimore parauniversitare për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, garanton mirëadministrimin e burimeve njerëzore për institucionet publike të arsimit parauniversitar, është përgjegjës për rekrutimin e mësuesve nëpërmjet portalit Kombëtar “Mësues për Shqipërinë” etj.

2. Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale dhe sensitive për subjektet e të dhënave personale “punëmarrës”, “nxënës”, “prindër” etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

Nga verifikimi i kryer rezulton se institucioni ka krijuar në platformën e facebook një profil zyrtar, në të cilin pasqyron aktivitete të zhvilluara, ndër të tjera, nga shkollat nën varësi, duke i ilustruar nëpërmjet fotografive dhe videove të nxënësve (fëmijë-minoren), të marra gjatë klasave mësimore, aktivitete sportive, etj., në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit si dhe Udhëzimit nr. 4 të Komisionerit, datë 16.03.2010 për “Marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit” (në vijim, “Udhëzimi nr. 4”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi si përgjegjës për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tij, ka detyrimin të marrë masa në lidhje me ligjshmërinë e përpunimit e të dhënave personale, në respektim të parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore të përpunimit, ku parashikohet se përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të Ligjit.

3. Kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave (prindër dhe/ose kujdestar ligjor të fëmijëve) për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale (fotografi dhe video), për mënyrën e përpunimit, të drejtën për akses, të drejtën për fshirje dhe/ose korrigjim të të dhënave të tij etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mos përmbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

4. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezulton se Kontrolluesi ka “Njoftuar” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës. Gjatë hetimit administrativ të ushtruar, është konstatuar se “Njoftimi” ka mangësi në deklarinë, sa i përket rubrikave të formularit si vijon:

- i. Deklarimin në rubrikën 2, të formularit të njoftimit “personi i kontaktit ngarkuar nga subjekti”;

- ii. Deklarimin në rubrikën 3, të formularit të njoftimit “*kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen*”;
- iii. Deklarimin në rubrikën 4, të formularit të njoftimit “*kategoritë e të dhënave personale që përpunohen*”;
- iv. Deklarimin në rubrikën 5, të formularit të njoftimit “*të dhënat sensitive që përpunohen*”;
- v. Deklarimin në rubrikën 6, të formularit të njoftimit “*qëllimi i përpunimit*”;
- vi. Deklarimin në rubrikën 7, të formularit të njoftimit “*marrësi i të dhënave personale*”.

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

5. Kontrolluesi disponon rregullore “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, por konstatohet se rregullorja nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një “*Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit, datë 14.09.2018 “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*”, (në vijim, “*Udhëzimi nr. 47*”), duke mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

6. Kontrolluesi administron vetëm një adresë zyrtare të postës elektronike (zvalushnje@arsimi.gov.al), nëpërmjet të cilës komunikohet me drejtorët e shkollave, institucionet eprore dhe/ose subjektet e të dhënave. Konstatohet se të gjithë shkollat nën varësi, kanë krijuar adresa emaili në domain-et private yahoo.com, gmail.com, live.com, etj., nëpërmjet të cilave komunikojnë ndër të tjera, edhe të dhënat personale të subjekteve të të dhënave nxënës, mësues etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, komunikimi elektronik i të dhënave nëpërmjet adresave email nën domain-et private, rrezikon cënimin e të dhënave personale të cilat komunikohen midis palëve, pasi platformat teknologjike të tipit mail-server që përdoren, nuk janë në administrimin e vetë institucionit apo institucioneve shtetërore

që ofrojnë këtë shërbim. Mos përdorimi i shërbimeve qeveritare TIK, në këtë rast të postës elektronike, të ngritura në rrjetin GovNet (shërbime qeveritare të standardizuara dhe të sigurta), cënon sigurinë dhe vazhdimësinë e informacionit të përpunuar nga punonjësit.

Kontrolluesi nuk ka marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht në këtë rast kur përpunimi i të dhënave kryhet nëpërmjet komunikimeve elektronike.

7. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Grupi i kontrollit konstaton mosplotësim të detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI), lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara nga Udhëzimi nr. 47, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë që Kontrolluesi ushtron.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vënë në dispozicion Kontrolluesit. Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Në seancë dëgjimore të organizuar nga Zyra e Komisionerit, janë paraqitur përfaqësuesit e Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitar Lushnjë, të cilët parashtruan pretendimet e tyre me shkrim, në lidhje me shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ, si më poshtë:

- Sa i përket konstatimit në lidhje me pikën 2 dhe pikën 3 të procesverbalit, Kontrolluesi argumenton se institucionet arsimore në varësinë e ZVAP-it kanë krijuar platformën Facebook, në të cilën pasqyrohen me video dhe fotografi aktivitetet mësimore dhe aktivitete të tjera në kuadër të pasqyrit të metodave edukative, ju bëjmë me dije se personat përgjegjës në këto institucione arsimore kontaktojnë me prindërit dhe kujdestaret ligjor të fëmijëve dhe pasi marrin aprovimin verbal të tyre procedojnë me publikimet. Duke qenë institucione të mëdha në numër, deri me tani nuk ka pasur asnjë ankesë nga prindërit ku të jenë bërë me dije institucionet arsimore për mosdashjen e publikimit të fëmijëve në këto rrjete sociale. Por ZVAP-i pasi mori Procesverbalin nga Komisioneri, ka kontaktuar me të gjithë institucionet që ka në varësi, bazuar në ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, për të

ndaluar shkeljen në fjalë duke proceduar me fshirjen e të gjitha materialeve të publikuara ose me marrjen e miratimit të prindërve/kujdestareve ligjor të fëmijëve.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, publikimi i të dhënave personale “fotografi” dhe “video”, të subjekteve të të dhënave “nxënës” të shkollave nën varësi të Kontrolluesit, në profile të rrjeteve sociale (apo të ngjashme), të administruara nga Kontrolluesi, nuk mund të kryhet në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale të parashikuara në germat “a”, “b” dhe “c” të nenit 5 dhe kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave të parashikuara në nenin 6 të Ligjit si dhe Udhëzimin nr. 4 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit administrativ dhe angazhimin e tij për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe eviton mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 6, 18, 21, 27, 29, 30, 31 pika 1, germa “a/1”, si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të marrë masa për përpunimin e të dhënave personale në përputhje me dispozitat e parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit, duke përdorur sfumatuara në fotografitë dhe videot e nxënësve (fëmijë-minoren), të publikuara në rrjetet sociale, ose duke marrë pëlqimin me shkrim të prindit të të miturit apo personit i cili gëzon përgjegjësinë prindërore, për publikimin e të dhënave të tyre, sipas parashikimit të pikës 24 të nenit 3 të Ligjit.
2. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të marrë masa konkrete, për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale;
3. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të marrë masa për përditësimin e “Njoftimit” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
4. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të marrë masa për përditësimin e rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi.
5. Kontrolluesi, të marrë masa për garantimin e sigurisë së informacionit të përpunuar nga punonjësit, duke shmangur përdorimin e adresave elektronike personale nëpërmjet domaineve private, duke i zëvendësuar me shërbimet e ofruara qeveritare TIK, të standardizuara dhe të sigurta;

6. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e stafit të tij si dhe sa i përket krijimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;
7. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) menjëherë, detyrimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, më sipër;
 - (ii) brenda 10 (dhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 3 më sipër;
 - (iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 4 më sipër;
 - (iv) brenda 45 (dyzetepesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 5 dhe 6 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti.

8. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
9. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 13.12.2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

